

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Trajnim i punonjësve mësimorë të Zyrave Vendore Arsimore në varësi të DRAP Korçë viti 2025”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP): 80522000-9.

VLERA E FONDIT LIMIT: 6.663.000 (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Aktivitetet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional duhet të jenë të akredituara dhe njihen me kredite nga Agjencia e Sigurimit së Cilësisë së Arsimit Parauniversitar. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të dorëzojë vendimin e Komisionit të Akreditimit të Aktiviteteve të programeve / moduleve të trajnimit bashkëlidhur listën e moduleve të akredituara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe të Udhëzimit Nr.16 datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 1/b dhe pika 3, e LPP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesa të cilat garantojnë se operatorët ekonomik pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën si dhe në nenin 43 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon një kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”* Gjithashtu në përputhje me nenin 55, pika 4, paragrafi 1 dhe 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”*

Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni nr. 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si edhe rekomandimi APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, gërma b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara. Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë një punësim mesatar të paktën 5 (pesë) punonjës të punësuar, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërket nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 41, pika 4, gërma “c”. Kërkesa specifike për stafin e kërkuar është përcaktuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës është bërë analize mbi afatin e realizimit të shërbimit, mbi llojin e shërbimit, mënyrën si do të realizohet, volumin e punës për kryerjen e këtij shërbimi. Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky është një numër minimal i kërkuar për të vërtetuar kapacitetin e fuqisë punëtore që duhet për të bërë të mundur realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës. Numri i stafit ndihmës është përcaktuar në varësi të numrit të pjesëmarrësve në secilën qëndër trajnimi, për të siguruar mbështetje të plotë gjatë fazave të ndarjes së grupeve, shpërndarjes së materialeve, raportimeve dhe koordinimit të pjesëmarrësve. Ky përcaktim është bërë me qëllim optimizimin e burimeve njerëzore dhe financiare, duke ruajtur një raport të drejtë midis mbështetjes teknike dhe nevojave reale të trajnimit në secilën qëndër.

2.3.3 Operatoret ekonomik duhet të kenë në dispozicion për kryerjen e këtij trajnimi minimalisht 1 (një) trajnerë për secilin modul të kërkuar.

Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka në dispozicion trajnuesit e mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor dokumentet si më poshtë:

- Diplomës universitare
- CV e trajnerëve për çdo modul

Shenim: Te gjithë trajnuesit duhet të jene në listen e moduleve të akredituara.

Kjo kerkese do të konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe të Udhëzimit Nr.16 datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion stafin e kualifikuar, personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Çdo modul i trajnimit kërkon njohuri specifike dhe kompetenca të veçanta profesionale. Prania e një trajneri të dedikuar për secilin modul garanton se përmbajtja jepet nga persona me ekspertizë të specializuar dhe standarde profesionale të përcaktuara. Kërkesa që të gjithë trajnerët të jenë pjesë e listës së moduleve të akredituara garanton se programi i trajnimit është në përputhje me standardet ligjore dhe institucionale për ofrimin e trajnimeve të certifikuara.

Kriteri për stafin vendoset sipas specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës hartuar nga AK, për llogari të së cilit po zhvillohet procedura e prokurimit. Kërkesa për disponibilitetin e trajnuesve lidhet drejtpërdrejt me objektin e procedurës së prokurimit, i cili parashikon sigurimin e shërbimit të trajnimit të punonjësve mësimorë të Zyrave Vendore Arsimore.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të deklarojë garantimin e disponibilitetin e trajnerëve përgjatë gjithë periudhës së lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës/ave, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike. Kërkesa për disponibilitetin e trajnuesve lidhet drejtpërdrejt me objektin e procedurës së prokurimit, i cili parashikon sigurimin e shërbimit të trajnimit të punonjësve mësimorë të Zyrave Vendore Arsimore.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të deklarojë se merr përsipër të kryejë shërbimin, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës/ave, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.